




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Odeljenje za Zdravstvo i Socijalno Osiguranje

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

Nr. prot. 79
Br. prot. 1503.20.19
RAHOVEC - ORAHOVAC



Kuvendi i Komunës Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Odeljenje za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu
Department of Health and Social Welfare

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË DREJTORISË PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE 2018

Drejtori i DSHMS-së
Samir Mustafa

Rahovec, Dhjetor 2018

Hyrje

Raporti vjetor i punës për vitin 2018 i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Rahovec, paraqet punën, zhvillimin dhe të arriturat kryesore të Drejtorisë dhe stafit të saj. Përmes këtij raporti, DSHMS, paraqet detyrat dhe të arriturat drejt realizimit të planit të punës si dhe detyrat tjera që dalin sipas detyrës zyrtare për të ofruar shërbime sa më cilësore për qytetarët e komunës së Rahovecit . DSHMS-ja ka bashkëpunuar dhe mbështetur organizatat joqeveritare të cilat kanë qenë të gatshme për bashkëpunim, ku kemi pasur suksese në të gjitha fushat duke ndihmuar në realizimin e qëllimit të përbashkët kundrejt qytetarëve të komunës tonë. Caktimi i prioritetëve të punës dhe përcjelljen e nevojave sociale, shërbimeve shëndetësore ka qenë punë e përditshme e DSHMS-së dhe stafit të saj.

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Aktivitetet e DSHMS-së për periudhën raportuese janë:

- Konsultimet dhe takimet e rregullta me stafin, Drejtorin e QPS-së dhe QKMF-së në Rahovec,
 - Përpilimi i raporteve mujore të punës për vitin 2018, dhe krijimi nevojës për raportim të vazhdueshëm,
 - Angazhimi rreth përmirësimit të kushteve për punë të nëpunësve dhe stafit në përgjithësi në kuadër të DSHMS-së,
 - Shqyrtimi dhe përgjigjja me kohë të kërkesave të ndryshme të qytetarëve, si dhe të atyre për ndihmë momentale-financiare,
 - Pjesëmarrja aktive në kolegjiun e drejtorëve të DSHMS-së, në cilësinë e anëtarit të kryesisë në kuadër të Asociacionit të Komunave.
-

- **Të ariturat e drejtorisë së shëndetësisë, për vitin 2018**
- Ofrimin e shërbimeve mjekësore në dy ndërime në dy QMF-të, në Krushë të Madhe, dhe Rakoc.
- Vaksinimi permanent në QMF, në Apterush ku gravitonjë popullata e fshatrave Zaqisht, Reti, dhe Reti e Ulet.
- Nënshkrimi i marveshjes me Karitas Kosova, për ofrimin e shërbimit të kujdesit shtëpiak “Home Care” për persona në regjim shtrati, numëri i të punësuarve me këtë marëveshje është 43 punëtor shëndetësorë.
- Ndërtimi i objektit të qendrës kryesore të mjekësisë familjare dhe emergjenca faza e parë, si dhe renovimi i objekteve shëndetësore në komunën e Rahovecit.
- Spërkatja kundër rriqnave pasi Rahoveci njihet si një zonë endemike nga pickimet me rriqnat.
- Vizitat sistematike mjekësore të nxanseve në shkollat e komunës së Rahovecit.
- Drejtoria e shëndetësisë në vitin 2018 ka marrë donacione, si një Autoambulac, paisje mjekësore nga kompania telefonike “IPKO” për nevojat e repartit të Gjinokologjisë, si dhe donacione nga organizatat ndërkombëtare siq është AQH-ja, po ashtu kemi marrë donacion edhe barnat për QMF, në Apterush, nga mërgimtarët për furnizim me barna për nevojat e QMF-së, në Apterush, po ashtu kemi marrë donacione nga bashkëatdhetar karriga për persona me nevoja të veqnata po ashtu pacientet (200 pacient) me probleme me sy janë paisë me syzat sipas nevojës.

Krahasimi me vitin 2017, kemi shërbime më të mira mjekësore, ritje të stafit shëndetësorë, në dy QMF-të, Ratkoc, dhe Krushë Të Madhe kemi aplikuar shërbime mjekësore në dy ndërime, funksionalizimi i AMF-së, në fshatin polluzh, me nënshkrimin e marëveshjes me Karitas Kosova ku janë punësuar 43 punëtor shëndetësorë janë përmisur dukshëm shërbime mjekësore, vaksinimi permanent në QMF në Apterush, po ashtu kemi ofru shërbime fizioterapeotike për pacientët në nevoj që më heret nuk ka pas, kemi marrë donacione paisjet mjekësore për repartine gjinokologjisë, autoambulanc, dhe donacione tjera për nevojat e QKMF.

Sfidat e drejtorisë së shëndetësisë për vitin 2018 ka qenë hapja e Hemodializës gjë që nuk kemi mundur ta lëshojm në përdorim për pacientët në nevoj, dhe ndërtimi i qendrës kryesore të mjekësisë familjare - emergjenca, ndërtimi i qendrës kryesore të mjekësisë familjare – emergjenca ky projekt dot përfundoj brenda vitit 2019 po ashtu si drejtori ne ballafaqohemi me mungesë stafit të personelit shëndetësor.
